



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1919/7 prot

Datë 28.08.2024

**V E N D I M**

**Nr. 1126/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.08.2024 me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-07666-05-31-2024, me objekt: “*Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjetllësit nga Impianti i Bovillës - Depo Maloku, Bashkia Kamëz*”, me fond limit 63,014,765.5 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz ShA.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, me NIPT (J91915001P) dhe adresë: Lagjja “Zall-Mner I Ri”, Rruga Nacionale Kamëz, 1054, Kamëz

**Autoriteti Kontraktor:**

Ujësjetllës Kanalizime Kamëz ShA, me adresë: Rruga “Paqësori”, Frutikulturë, Kamëz

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*”

*publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.06.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-07666-05-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjellësit nga Impianti i Bovillës - Depo Maloku, Bashkia Kamëz”, me fond limit 63,014,765.5 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Kamëz ShA.

II.2. Në datën 03.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Desaret Company” SHPK & “Aurora Konstruksion” SHPK	40,561,836.72 lekë, skualifikuar
2. “Almo Konsruksion” SHPK	45,347,759 lekë, skualifikuar
3. “Nika” SHPK	49,696,512.23 lekë, skualifikuar
4. “NG Structures” SHPK	50,819,479 lekë, kualifikuar
5. “Kacdedja” SHPK	52,319,674 lekë, skualifikuar
6. BOE “Britania” SHPK & “Shpresa-Al” SHPK	53,472,747 lekë, skualifikuar
7. “Liqeni VII” SHPK	54,787,863 lekë, kualifikuar
8. “Be-Is” SHPK	55,269,440 lekë, kualifikuar
9. “L.T.E Construction” SHPK	56,087,596.31 lekë, skualifikuar
10. “Shendelli” SHPK	63,009,117 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

*“2. Operatori ekonomik ALMO Konstruksion sh.p.k skualifikohet nga ky tender per arsyet e poshteshenuara :*

*2.3 Kapaciteti teknik:*

*2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:*

- Tuba e Rakorderi Ujesjellesi PE-100 RC d=500 mm, t=45.4, PN 16*
- Saraçineska Gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø400*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

*1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributorprodhues për listën e mësipërme të mallrave.*

*2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.*

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

*3. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme.*

*Kriteri 2.3.5 kapaciteti teknik I kriterëve të veçanta për kualifikim për mallin Saraçineska Gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø400 nuk plotësohet nga operatori ekonomik ALMO Konstruksion shpk për arsyet e poshteshenuara:*

*I. Mungon autorizimi/marrëveshja që tregon lidhjen midis distributorit dhe prodhuesit.*

*II. Mungon katalogu/fragmente të katalogut që të tregojë dhe të specifikojë mallin e mesipërm.*

*III. Çertifikata ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme e prodhuesit është ne gjuhë të huaj. (Referuar kritereve për kualifikim të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.*

*Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.)*

*Shenim: Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.*

*Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.”*

II.3. Në datën 11.07.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak në SPE.

II.4 Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4323, datë 15.07.2024 dhe nr. Protokollit 1919/2024, datë 15.07.2024, të operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Konkretisht në ankesën e tij, operatori ekonomik ankimes pretendon:

*“Referuar kërkesave se mesipërme për të vërtetuar se Operatori ekonomik Shoqeria ALMO Konstruksion shpk i plotëson të gjitha kriteret e kualifikimit përfshirë edhe kriterin 2.3.5 ku ka paraqitur për zërin Tuba e Rakorderi Ujesjellesi PE-100 RC d=500 mm, t=45.4, PN 16 Autorizim të leshuar nga shoqeria A.M.U sh.pk ku autorizon operatorin ekonomik Shoqerine ALMO Konstruksion që të ofrojë në tender ofertën e tij për produktet e kompanisë prodhuese KONTI HIDROPLAST për të cilat në janë distributor zyrtar të autorizuar për të tregtuar produktet e tyre në Shqipëri. Gjithashtu kemi dorëzuar edhe skedën teknike të Tubit si dhe Certifikatën ISO të Prodhuarit. I gjithë dokumentacioni është paraqitur në origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin të gjitha në gjuhën shqipe në Sistemin e Prokurimit Elektronik brenda afateve të përcaktuara nga AK në datën e zhvillimit të tenderit.*

Autoriteti kontraktor mund ta verifikojë lehtësisht dokumentacionin e deklaruar dhe dorezuar në SPE nga operatori ekonomik Shoqëria ALMO Konstruksion në faqen zyrtare të kompanisë prodhuese KONTI HIDROPLAST në ËEB . Te gjitha të dhënat e kompanisë prodhuese janë paraqitur dhe në autorizimin që operatori ekonomik Shoqëria ALMO Konstruksion ka nga shoqëria A.M.U sh.pk.

Per Zerin Saraçineska Gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø400 Operatori ekonomik Shoqëria ALMO Konstruksion shpk ka paraqitur Autorizim të leshuar nga shoqëria A.M.U sh.pk ku autorizon operatorin ekonomik Shoqëria ALMO Konstruksion që të ofrojë në tender ofertën e tij për produktet e kompanisë prodhuese Austriake E. Haële Armaturenëerke GmbH për të cilat janë distributor zyrtar të autorizuar për të tregtuar produktet e tyre në Shqipëri. (Bashkangjitur Autorizimi).

Autoriteti kontraktor mund ta verifikojë lehtësisht dokumentacionin e deklaruar dhe dorezuar në SPE nga operatori ekonomik Shoqëria ALMO Konstruksion shpk në faqen zyrtare të kompanisë prodhuese Austriake E. Haële Armaturenëerke GmbH në ëeb. Te gjitha të dhënat e kompanisë prodhuese janë paraqitur dhe në autorizimin që operatori ekonomik Shoqëria ALMO Konstruksion ka nga shoqëria distributore A.M.U sh.pk.

Kompania prodhuese Austriake E. Haële Armaturenëerke GmbH është një kompani e cila e ka filluar aktivitetin e saj që në vitin 1948.

Sot Haële Austria Group nuk është vetëm ndër prodhuesit kryesorë në botë të Saracineskave të gizes me fllanxha. Ajo gjithashtu ofron një shumëllojshmëri të gjere të llojeve të tjera të Saracineskave, duke përfshirë valvulat flutur, kontrolli, shërbimi dhe ajri, si dhe lloje të ndryshme hidrantesh zjarri, pajisje dhe lidhje tubash.

Edhe shoqëria AMU e cila e ka filluar aktivitetin e saj që në vitin 2001 fillimisht me tregtimin e materialeve të një cilësie të lartë për ujësjellës dhe me pas duke i ndermarre dhe vetë keto punë. Falë aktivitetit të shumtë në këtë profil shoqëria AMU ka fituar një përvojë të çmuar në këtë fushë por dhe një reputacion të mirë për punime cilësore të kësaj natyre dhe tregtimin e produkteve me standarte të larta teknike.

Por nuk jemi këtu për të folur për arritjet e Kompanisë prodhuese Austriake E. Haële Armaturenëerke GmbH dhe të kompanisë AMU shpk. Këtë përshkrim të shkurtër e bëjmë për të sjellë edhe një herë në vëmendje se sa lehtësisht e aksesueshme është një skedë teknike apo katalog i këtyre kompanive nëpërmjet faqeve zyrtare të tyre në ëeb konkretisht <https://amu.al/> dhe <https://ëëë.haële.com/en/products>.

Pra, për sa më sipër referuar arsyes së kualifikimit Komisioni Vlerësimit të Ofertave për një shqyrtim të drejtë dhe ligjor të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik në SPE e ka pasur lehtësisht të verifikueshme faktin mbi verifikimin e skedave teknike. Gjithashtu në faqet zyrtare të specifikuar më sipër të secilës kompani prezantohen të njëjtat produkte gjë që verteton dhe marrëdhënien e ngushtë të bashkëpunimit që kanë midis tyre.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka aksesin e nevojshëm të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kerkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për keto sqarime.

Në lidhje me rendesinë e këtij kriteri në deklaratat e firmosura dhe të dorezuara në SPE operatori Ekonomik Shoqëria ALMO Konstruksion shpk garanton autoritetin kontraktor për

kapacitetet teknike per permbushjen me sukses te kontrates sipas te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara.

Referuar arsyes e trete te skualifikimit Certifikata ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut.

Subjekte te cilat operojne prej vitesh në tregun Shqiptar, në fushën e certifikimit të kompanive sipas standardeve ndërkombëtare ISO, i leshojne certifikatat ISO ne dy gjuhe, ne anglisht dhe ne Shqip ku gjuha e pare e perdorur ne certifikate eshte ajo anglisht.

Operatori Ekonomik Shoqeria ALMO Konstruksion shpk ne kete procedure prokurimi ka ofertuar produkte te nje cilesie te larte me standartet e tregut vertetuar kjo edhe nga Certifikata ISO.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka percaktuar se dokumentacionin i sipercituar duhet te paraqitet nga operoret ekonomik ne sistemin e prokurimit elektronik (SPE) me qellimim verifikimin e plotesimit/mosplotesimit nga operoret ekonomik pjesemarrres te kriterit te sipercituar duke garantuar Autoritetin Kontraktor se mallrat qe do te furnizojne do te jene prodhim sipas kerkesave te projektit.

Sa me siper, operatori Ekonomik Shoqeria ALMO Konstruksion shpk me dokumentacionin qe ka dorezuar ne kete procedure prokurimi, garanton autoritetin kontraktor per realizimin me sukses dhe cilesi te kontrates qe mallrat kryesore do te jene ne perputhje me standartet me te mira europiane. Komisioni i vleresimit te Ofertave duhet te kryente verifikimet e nevojshme te dokumentacionit te dorezuar nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari per sa kohe qe ka qene brenda afateve procedurale te njohur nga ligji (para shpalljes paraprake te fituesit).

Autoriteti kontraktor, duke qene se eshte perfituuesi direkt i kontrates objekt prokurimi, eshte ne te drejten e tij qe pasi te kete bere verifikimet e nevojshme qe te kualifikoje dy ose me shume ofertues qe plotesojne kriteret ne raport me dokumentat standarte dhe ligjet.

Operatori Ekonomik Shoqeria ALMO Konstruksion shpk ka ofertuar per kryerjen e punimeve ne vleren e ofertes prej 45.347.759 (Dyzete e pese milion e treqind e dyzete e shtate mije e shtateqind e pesedhjetete e nente) leke pa Tvsh, vlere e cila eshte skualifikuar nga KVO dhe eshte shpallur fitues paraprak operatori ekonomik shoqeria NG STRUCTURES me vleren e ofertes prej 50.819.479 (Pesedhjetete milion e teteqind e nentembedhjetete mije e katerqind e shtatedhjetete e nente) leke pa tvsh. Sic shihet operatori ekonomik shoqeria NG STRUCTURES eshte shpallur fitues paraprak edhe pse oferton 5.471.720 (pese milion e katerqind e shtatedhjetete e nje mije e shtateqind e njetete) leke pa tvsh me shume se oferta jone.

Gjithashtu theksojme se Autoriteti kontraktor publikoi dokumentat Standarte te Tenderit ne sistemin e prokurimit (SPE) ne kundërshtim me ligjin e prokurimit publik duke ndaluar operoret ekonomike te interesuar te Mbeshteten ne kapacitetet e subjekteve te tjera, sic parashihet ne ligj, por kjo kerkese u ndryshua vetem pas kerkesave te shumta te operoreve ekonomik te interesuar. Per sa me siper mendojme, se autoriteti kontraktor ne perputhje me nenin 2 te ligjit 162/2020 "Per prokurimin publik" ka per detyrim b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; te nxise pjesemarrjen e operoreve

*ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.*

*Duke pare llogjiken e perdorur por edhe veprimet e KVO-se me kete procedure kemi dyshime te forta se keto veprime jane te qellimshme dhe se kemi te bejme me mjaft prova qe vertetojne ndodhjen perpara disa veprave penale si Neni 258 (Shkelja e barazise se pjesemaresve ne tendera apo ankande publike), Neni 259 (Korrupsion pasiv i personave qe ushtrojne funksione publike).*

*Sic dihen keto vepra penale hetohen nga organe te specializuara dhe ne per te gjitha keto konstatime per kete procedure dhe me gjere, per te qartuesur te gjitha situaten kemi pergatitur informacionin e duhur per te cilin jemi ne proces perfundimit te tij.*

*Mbeshtetur ne kerkesat e kualifikimit si dhe ne nenin 76 dhe 77 te Ligjit te Prokurimit Publik, Operatori Ekonomik Shoqeria ALMO Konstruksion shpk ploteson plotesisht kapacitetet per permbushjen me sukses te kontrates.*

*Referuar analizës së mësipërme Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave dhe Komisioni i Prokurimit Publik të gjykoje dhe të vleresoje me rigorozitet të gjitha pikat e ankimimit tone, të veprave me transparence në mënyrë proporcionale me rigorozitet, integritet në respektim të plote të parimit të drejtësisë, objektivitetit dhe paanshmesisë si dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues.*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave dhe Komisioni i Prokurimit Publik nuk duhet të harroje qellimin e ligjit të prokurimit publik, si në drejtim të sigurimit të trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë por edhe atë të mireperdorimit të fondeve publike dhe shpenzimeve procedurale. Per sa me sipër kërkojme pranimin e ankesës tone sipas objektit të saj.”*

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1919/2 Prot., datë 16.07.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Me shkresën nr. 1326/7 prot, datë 22.07.2024, me objekt: “Dërgim i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”, protokolluar me tonën me nr. 1919/3 prot. datë 25.07.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit, si dhe aktin e trajtimit të ankësës së operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

II.7. Në datën 06.08.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, me anë të shkresës nr. 1326/6 prot, datë 19.07.2024, protokolluar me tonën me nr.1919/4 prot., datë 06.08.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi procedurën e prokurimit.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të “Ligjit për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, se arsyet e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “[...] Kriteri 2.3.5 kapaciteti teknik I kriterëve të veçanta për kualifikim për mallin Saraçineska Gize me fllanxa, Pn deri 16 bar, Ø400 nuk plotësohet nga operatori ekonomik ALMO Konstruksion shpk për arsyet e poshteshuara:

*I. Mungon autorizimi/marreveshja që tregon lidhjen midis distributorit dhe prodhuesit.*

*II. Mungon katalogu/fragmente të katalogut që të tregojë dhe të specifikojë mallin e mesiperm.*

*III. Çertifikata ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme e prodhuesit është në gjuhë të huaj. (Referuar kriterëve për kualifikim të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.*

*Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

**2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:**

- ***Tuba e Rakorderi Ujesjellesi PE-100 RC d=500 mm, t=45.4, PN 16***
- ***Saraçineska Gize me fllanxa, Pn deri 16 bar, Ø400***

#### **Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

- 1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave.***
- 2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.***



**Shënim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Dokumentin “Autorizim distributori” datë 12.06.2024, të lëshuar nga kompania “A.M.U” SHPK, me përmbajtje **“Kompania A.M.U shpk me administrator z.E.K, me Nipt [...], autorizojmë shoqërinë “Almo Konstruksion” shpk [...], të ofrojë në tender produktet e kompanisë prodhuese Austriake E.Hawle Armaturenwerke GmbH, [...] për të cilat ne jemi distributor zyrtar të autorizuar për të tregtuar produktet e tyre në Shqipëri. Ky autorizim është i vlefshëm për tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit të linjës së furnizimit të ujësjellësit nga Impianti i Bovillës – Depo Maloku, Bashkia Kamëz”, zhvilluar nga autoriteti kontraktor “Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a” me numër REF-07666-05-31-2024. Në rast se operatori ekonomik do të shpallet fitues, në si distributor të autorizuar do të bëjmë furnizimin sipas preventivit. [...]”**;
- Dokumentin “Autorizim distributori” datë 12.06.2024, të lëshuar nga kompania “A.M.U” SHPK, me përmbajtje **“Kompania A.M.U shpk me administrator z.E.K, me Nipt [...], autorizojmë shoqërinë “Almo Konstruksion” shpk [...], të ofrojë në tender produktet e kompanisë prodhuese Konti Hidroplast, Maqedoni, tuba HDPE, RC etj, [...] për të cilat ne jemi distributor zyrtar të autorizuar për të tregtuar produktet e tyre në Shqipëri. Ky autorizim është i vlefshëm për tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit të linjës së furnizimit të ujësjellësit nga Impianti i Bovillës – Depo Maloku, Bashkia Kamëz”, zhvilluar nga autoriteti kontraktor “Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a” me numër REF-07666-05-31-2024. Në rast se operatori ekonomik do të shpallet fitues, në si distributor të autorizuar do të bëjmë furnizimin sipas preventivit. [...]”**;
- Dokumentin “Autorizim”, datë 10.11.2020, të lëshuar nga kompania Konti Hidroplast, me përmbajtje **“Ne, Konti Hidroplast, me zyrat tona në [...], me anë të kësaj autorizojmë shoqërinë “AMU” SHPK me adresë [...], që të shesë produktet tona në Shqipëri dhe të marrë pjesë në prokurim publik.”**, dokument ky i përkthyer dhe noterizuar.
- Skede teknike për artikujt tuba, nga prodhuesi Konti Hidroplast;
- Certifikatë ISO 9001:2015 “Sistem Menaxhim të Cilësisë”, për objektin “Projektimi, zhvillimi dhe prodhimi i tubave prej polietileni dhe polipropileni, pajisje, vula dhe puseta”, lëshuar për Konti Hidroplast DOOEL. (origjinal dhe i përkthyer);
- Certificate ISO 9001:2015 and ISO 14001:2015, E. Haële Armaturenëerke GmbH, has established and applies a Management System for “Development, production and sales of valves and fittings”, (e papërkthyer)

III.1.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.4. Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që “Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Tuba e Rakorderi Ujesjellesi PE-100 RC d=500 mm, t=45.4, PN 16
- Saraçineska Gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø400

Operatori ekonomik duhet të paraqesë: 1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave”. 2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. 3. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme.

III.1.7. Në ankesën e tij, operatori ekonomik ankimes pretendon: “[...] Per Zerin Saraçineska Gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø400 Operatori ekonomik Shoqeria ALMO Konstruksion

*shpk ka paraqitur Autorizim te leshuar nga shoqeria A.M.U sh.pk ku autorizon operatorin ekonomik Shoqerine ALMO Konstruksion qe te ofroje ne tender oferten e tij per produktet e kompanise prodhuese Austriake E. Haële Armaturenëerke GmbH per te cilat jane distributor zyrtar te autorizuar per te tregtuar produktet e tyre ne Shqiperi. (Bashkangjitur Autorizimi). Autoriteti kontraktor mund ta verifikojë lehtësisht dokumentacionin e deklaruar dhe dorëzuar ne SPE nga operatori ekonomik Shoqeria ALMO Konstruksion shpk ne faqen zyrtare te kompanise prodhuese Austriake E. Haële Armaturenëerke GmbH ne ëeb. Te gjitha te dhenat e kompanise prodhuese jane paraqitur dhe ne autorizimin qe operatori ekonomik Shoqeria ALMO Konstruksion ka nga shoqeria distributore A.M.U sh.pk.*

*Kompania prodhuese Austriake E. Haële Armaturenëerke GmbH eshte nje kompani e cila e ka filluar aktivitetin e saj qe ne vitin 1948.*

*Sot Haële Austria Group nuk eshte vetem nder prodhuesit kryesore ne bote te Sarcineskave te gizes me flanaxha. Ajo gjithashtu ofron nje shumellojshmeri te gjere te llojeve te tjera te Saracineskave, duke perfshire valvulat flutur, kontrolli, sherbimi dhe ajri, si dhe lloje te ndryshme hidrantesh zjarri, pajisje dhe lidhje tubash.*

*Edhe shoqeria AMU e cila e ka filluar aktivitetin e saj qe ne vitin 2001 fillimisht me tregtimin e materialeve te nje cilesie te larte per ujesjellesa e me pas duke i ndermarre dhe vete keto pune. Fale aktiviteteteve te shumta ne kete profil shoqeria AMU ka fituar nje pervoje te cmuar ne kete fushe por dhe nje reputacion te mire per punime cilesore te kesaj natyre dhe tregtimin e produkteve me standarte te larta teknike.*

*Por nuk jemi ketu per te folur per arritjet e Kompanise prodhuese Austriake E. Haële Armaturenëerke GmbH dhe te kompanise AMU shpk. Kete perskrim te shkurter e beme per te sjelle edhe nje here ne vemendje se sa lehtësisht e aksesueshme eshte nje skede teknike apo katalog I ketyre kompanive nepermjet faqeve zyrtare te tyre ne ëeb konkretisht <https://amu.al/> dhe <https://ëë.haële.com/en/products>.*

III.1.8. Nisur nga arsyet e skualifikimit, si dhe pretendimet e vetë ankimuesit, i cili në ankesën e tij deklaroi se për për artikullin *Saraçineska Gize me flanaxha, Pn deri 16 bar, Ø400*, ka dorëzuar dokumentacion nga kompania prodhuese Austriake E.Haële Armaturenëerke GmbH, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin “Autorizim distributori” datë 12.06.2024, të lëshuar nga kompania “A.M.U” SHPK, i cili autorizon shoqërinë “**Almo Konstruksion**” shpk që të ofrojë në tender produktet e kompanisë prodhuese Austriake **E.Hawle Armaturenwerke GmbH**, për procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksioni i rrjetit të linjës së furnizimit të ujësjellësit nga Impianti i Bovillës – Depo Maloku, Bashkia Kamëz*”, zhvilluar nga autoriteti kontraktor “Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a” me numër REF-07666-05-31-2024.

Por, referuar kriterit të mësipërm, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, duke qenë se kompania “A.M.U” SHPK është distributor zyrtar i kompanisë prodhuese Austriake **E.Hawle Armaturenwerke GmbH**, për Shqipërinë, konstatohet se nuk është dorëzuar asnjë dokument i cili të vërtetojë lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar shoqërisë “A.M.U” SHPK, kërkesë kjo specifike në dokumentat e tenderit.

Akoma më tej, nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, në përmbushje të kriterit të kualifikimit, pikës 2.3.2/2, si dhe arsyeve të skualifikimit, konstatohet se nuk është dorëzuar asnjë katalog apo fragmente të katalogut të prodhuesit **E.Hawle Armaturenwerke GmbH**, për artikullin *Saraçineska Gize me fllanxa, Pn deri 16 bar, Ø400*, siç kërkohet në dokumentat e tenderit.

Gjithashtu, një nga kërkesat për kualifikim, në kriterin e mësipërm është se *“Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme”*, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, konstatohet se operatori ekonomik ankimues, për artikujt e furnizuar nga prodhuesi **E.Hawle Armaturenwerke GmbH** ka dorëzuar dokumentin *“Certificate ISO 9001:2015 and ISO 14001:2015, E. Haële Armaturenwerke GmbH, has established and applies a Management System for “Development, production and sales of valves and fittings”*, dokument i cili është i papërkthyer në gjuhën shqipe, ku referuar dokumentave të tenderit përcaktohet se *“Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përfundim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze”*.

Pra, sa më sipër, nisur nga arsyet e skualifikimit, por edhe vetë pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në ankesën e tij, si dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit në SPE, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit, konstatohet se dokumentacioni i dorëzuar për artikullin *Saraçineska Gize me fllanxa, Pn deri 16 bar, Ø400*, nuk është i plotë dhe në përputhje me pikën 2.3.5 të *“Kapacitetit teknik”*, të dokumentave të tenderit.

III.1.9. KPP sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.10. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit

Publik gjykon se operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK nuk ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.5 të “Kapacitetit teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në lidhje me artikullin *Saraçineska Gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø400*.

III.1.11. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.1.12. Gjithashtu, për sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me hartimin e kriterëve të kualifikimit, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” në të cilin parashikohet se “*1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “*1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*”

*Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...].*

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Almo Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-07666-05-31-2024, me object: “Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjetës nga Impianti i Bovillës - Depo Maloku, Bashkia Kamëz”, me fond limit 63,014,765.5 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Kamëz ShA.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

